



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: **“DRINI-1”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78716317H**, me seli:
*Shkoder, Puke, PUKË, Lagja Lajthize, Ish Zona Industriale, Pasuria Nr.1567, Zona
Kadastrale Nr.3069, Qyteti Puke.*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“E Hapur e Thjeshtuar - Punë”**, *prokurim elektronik.*

Numri i Procedurës/ referenca e Lotit: **REF-29707-11-15-2024.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtimin e ambienteve rekreative dhe struktura ekologjike turistike në kuadër të projektit me titull “Menaxhimi i koordinuar për binomin mjedis-turizëm, potencial për zhvillim social dhe ekonomik në NJVV Mat”**, me fond limit në vlerën: **8,670,000** (tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit, me afat zbatimi: **60** (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **18 Nëntor 2024.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Nr. 81, datë 25 Nëntor 2024**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “**DRINI-1**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78716317H**.

Vlera: **8 550 000** (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**.

2. Operatori Ekonomik: “**TIEN**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **M02302028V**.

Vlera: **8 599 000** (tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) **lekë pa TVSH**.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “**TIEN**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **M02302028V**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “TIEN” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 1 gërma “a”** 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, nuk është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, Seksioni C:DEKLARATË ”Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 1 gërma “b”** 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se nuk është paraqitur Sigurimi i Ofertës , sipas Shtojcës 3.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.4/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi për këtë kriter nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon:

- jo më pak se **1 (një)** punonjës Teknik ndërtimi.
- jo më pak se **1 (një)** punonjës Teknik topograf

- jo më pak se **1 (një)** punonjës Pllakashtrues
- jo më pak se **1 (një)** punonjës Elektriçist
- jo më pak se **1 (një)** punonjës Hidraulik
- jo më pak se **3 (tre)** punonjës Specialist Marangoz/ Mobilier
- **1 (një)** punonjës që përmbush kriteret për të qenë përgjegjës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.6 gërma "d"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi për këtë kriter nga ana e operatorit ekonomik pjesmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

VI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: **DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon:

- **2 (dy)** shoferë të mjeteve (të cilët duhet të disponojnë leje drejtimi me kategorinë "C")
- **1 (një)** manovratorë/automakinist

VII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin C: **DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"**/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon automjetet, makineritë dhe pajisjet kërkuara.

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.9/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi për këtë kriter nga ana e operatorit ekonomik pjesmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: **"DRINI-1"** Sh.p.k., me seli: *Shkoder, Puke, PUKË, Lagja Lajthize, Ish Zona Industriale, Pasuria Nr.1567, Zona Kadastrale Nr.3069, Qyteti Puke*, me numër Nipt-i: **J78716317H**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **8 550 000 (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *"Për Prokurimin Publik"*, të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor